



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:080622

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05537972

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Dren rogova dhe Krenar Berisha anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Unicorn” ShPK, me seli në Pejë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson P.A.Zh. nga Peja, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal KF.nr.165/22, të datës 08.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet ankesa e të paditurës, Administrata Tatimore e Kosovës, e dt.22.12.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal KF.nr.165/22, i datës 08.11.2023, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, në pikën I të dispozitivit ka vendosur Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit “Unicorn” Sh.P.K me seli në Pejë, në pikën II. Anulohet Pjesërisht vendimi i të paditurit, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.603/2019 i datës 12.03.2020, dhe atë vetëm në pjesën që i referohet mjeteve të paguara më tepër në shumën prej 11,979.90 €, në emër të ndëshkimit prej 25 %. Në pikën III. Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Unicorn” Sh.P.K me seli në Pejë, t’ia njeh shumën prej 11,979.90 €, si kreditim me të drejtë rimbursimi ose shfrytëzimi në periudhat tjera tatimore. IV. Mbetet Në Fuqi vendimi i të paditurit, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.603/2019 i datës 12.03.2020 në pjesën jo kontestuese dhe atë referuar shpenzimeve të sigurimeve dhe shpenzimeve të derivateve të naftës të konstatuara me raport kontrolli dhe të vërtetuar me vendimin kontestues nr.603/2019 të datës 12.03.2020. Në pikën V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij vendimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura ATK, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës ATK, të anulohet Aktgjykimi KF.nr.165/22 i datës 08.11.2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së parë - Departamenti Fiskal dhe të mbetet në fuqi vendimi i Departamentit të Ankesave të ATK-së nr.603/2019 datë 12.03.2020.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me Vendimin nr.603/2019 të datës 12.03.2020 ka aprovuar pjesërisht ankesën nr.603/2019 e datës 27.12.2019 e subjektit në procedurë “Unicorn” ShPK N.P.T “HANA TEX”, me numër fiskal (NRF) 600338661/810747090, me pronar z.Isa Morina, me seli të biznesit Fusha e Pejës Zona Industriale – Pejë, në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit nr.05/L-031 “Për Procedurën Administrative”, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe ndryshohen Njoftim Rivlerësimet e periudhave CD 2018, TVSH 12/2018 dhe 10/2018 ndërsa pjesa tjetër e vlerësimeve mbetet e pandryshuar dhe obligim për tatimpaguesin.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, paditësi, ushtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në procedurë të konfliktit administrativ. Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim janë cekur vlerësimet juridike të gjykatës të cilat janë mbështetur edhe në ekspertizën financiare të datës 14.03.2023 dhe sqarimeve të paraqitura edhe në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 08.11.2023, nga ana e ekspertit financiar Xh.K., për detyrat e caktuara për ekspertizë, ku është dhënë mendimi profesional për secilën pikë veç e veç. Në aktgjykimin e kontestuar është theksuar se Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të ekspertit financiar Xh.K., në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale e mbështetur në bazë të mjaftueshme ligjore, ka konstatuar drejtë gjendjen faktike bazuar në prova dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat. Gjykata nuk pajtohet me qëndrimin e të paditurit dhënë në arsyetimin e vendimit kontestues ku thuhet se “Gjatë kontrollit vlerësohet se faturat nga subjekti Univerzal nuk janë të deklaruara, pagesat nga subjekti Agro Liquid dhe duke bërë analizë materiale të disa faturave të blerjes, shitjes dhe stokut 31.12.2019 të disa artikujve është

konstatuar mall pa origjinë në shumë prej 47,919.60 euro për mallin pa origjinë ndëshkimin prej 11,979.90 euro në periudhën 12/2018”, kjo për faktin se në rastin konkret gjykata vlerëson se eksperti financiar drejtë ka konstatuar se kalkulimet për mallin pa origjinë janë të pa pranueshme dhe të pa verifikuara, nuk sqarohet procesi i kontabilitetit që ka ndodhë me këto mallra”. Vlerësimi në mënyrë të gabuar të mallit pa origjinë dhe ndëshkimi shumë prej 11,979.90 €, sepse në regjistrimin e mallrave me datën 05.01.2019 kjo sasi ka qenë prezentë në depo por si mall i huaj apo mall i shitur, dhe se ky mall duhet të hiqet nga KMSH dhe të rritet tatimi në fitim, e jo të trajtohet si mall pa origjinë nga ATK-ja por në stok mos të hynë sepse nuk është mall i SH.P.K “Unicorn” me seli në Pejë, por pa këtë mall ashti si ka qenë gjendja te tatimpaguesi.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të gjykatës së shkallës së parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 44 të LKA, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, ekspertizës financiare si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar, duke e anuluar pjesërisht vendimin nr.603/2019 i datës 12.03.2020 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe atë vetëm në pjesën që i referohet mjeteve të paguara më tepër në shumën prej 11,979.90 €, në emër të ndëshkimit prej 25 % dhe duke detyruar të paditurën Administratat Tatimore Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit që paditësit “Unicorn” Sh.P.K me seli në Pejë, t’ia njeh shumën prej 11,979.90 €, si kreditim me të drejtë rimbursimi ose shfrytëzimi në periudhat tjera tatimore.

Pretendimet ankimore të paditurës për shkelje të dispozitave të procedurës për faktin se Gjykata e shkallës së parë ka anuluar pjesërisht vendimin nr.603/2019 të datës 12.03.2020 të të paditurës dhe atë vetëm në pjesën që i referohet mjeteve të paguara më tepër në shumën prej 11,979.90€, rrjedhimisht duke vepruar në këtë mënyrë, Gjykata ka krijuar një situatë të paqartë juridike meqë edhe pse është vendosur meritorisht mbi çështjen e parashtruar nga paditësi, nuk është anuluar pikërisht vendimi fillestar i kontrollit, i nxjerr sipas formës për vizita përmbushëse, që në pikëpamje të procedurës administrative paraqet aktin fillestar. Kolegji i kësaj gjykate këtë pretendim të të paditurës e konsideron si të pabazë për faktin se neni 13 i LKA-së parasheh që “*Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë*”, andaj bazuar në këtë dispozitë ligjore gjykata e shkallës së parë nuk vlerëson ligjshmërinë e akteve fillestare administrative, mirëpo vetëm aktin administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. Pretendimi tjetër i paraqitur në ankesë se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës nga neni 182 paragrafi 1 i Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i cili gjen zbatim sipas nenit 63, të Ligjit nr.03/L-202 për

Konfliktet Administrative, në drejtim të asaj që e njëjta në këtë aktgjykim të ankimuar nuk ka trajtuar fare kundërshtimet e ekspertizës, e as nuk është lëshuar në trajtimin meritor të pretendimeve dhe argumentimeve të dhëna nga e paditura në proces gjyqësor, duke shkelur parimet bazë të procedurës administrative, konfliktit administrativ dhe procedurës kontestimore, dhe atë parimit të deklarimit të palës, duke mos i dhënë mundësi të deklarimit të paditurës, duke mos trajtuar meritorisht kundërshtimin e ekspertizës financiare të përcjellë nga e paditura. Për kolegjin e kësaj gjykata edhe ky pretendim është i pabazuar pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se e paditura ekspertizën financiare të datës 14.03.2023 së bashku me ftesën për seancë e ka pranuar me datë 16.08.2023, ndërsa seanca e shqyrtimit gjyqësor është mbajtur me datë 08.11.2023, që rrjedhimisht të paditura i është dhënë mundësia që t'i paraqes kundërshtimet në lidhje me ekspertizën financiare, e për të cilat eksperti financiar i ka dhënë sqarimet e nevojshme gjatë shqyrtimit kryesor, mirëpo në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ka prezantuar përfaqësuesi i paditësit edhe pse e njëjta ftesën për seancë e ka pranuar në mënyrë të rregullt. Kolegji kësaj gjykate i shqyrtoi në tërësi pretendimet e të paditurës në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji i kësaj gjykate ka shqyrtuar këto pretendime të njëpasnjëshme dhe të përsëritura, dhe konstaton se ekspertiza financiare ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike duke konstatuar se kalkulimet për mallin pa origjinë janë të pa pranueshme dhe të pa verifikuara, nuk sqarohet procesi i kontabilitetit që ka ndodhë me këto mallra. Vlerësimi në mënyrë të gabuar të mallit pa origjinë dhe ndëshkimi shumë prej 11,979.90 €, sepse në regjistrimin e mallrave me datën 05.01.2019 kjo sasi ka qenë prezentë në depo por si mall i huaj apo mall i shitur, dhe për këtë ka të siguruar provat që malli i është faturuar më herët subjektit ekonomik Mollakos Shpk dhe atë me nr. Faturë 32 të datës 31.12.2018 kjo provë vërteton se ky mall është me origjinë dhe se i njëjti është i dedikuar për shitësin gjë të cilën tatimpaguesi e ka realizuar me datë 17.01.2019. Këto prova dëshmojnë se ky mall në asnjë mënyrë nuk mund të jetë mall pa origjinë por mall që ka origjinën në detale të importit të mallit dhe përshkrimit të mallit në faturë ku të dhënat përputhën në tërësi me vlerën dhe karakteristikat e mallit që është konstatuar si mall pa origjinë.

Gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës, për arsye se, gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sipas kolegjit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e

ekspertizës financiare, si prova të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i pranon si të tilla edhe Kolegji, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, sepse gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të vërtetonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, për arsye se e paditura nuk ka ofruar prova të bazuara që do të ndryshonin gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të palëve ndërgjyqëse.

Mbi këtë gjendje të fakteve Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson, se gjykata e shkallës së parë, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 04/L-102, dhe të LKA-së, dhe nuk është cenuar e drejta dhe ligji në dëm të palëve ndërgjyqëse, pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi nuk vihet në dyshim, i njëjti vërtetohet si drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr. 72/24, me datë 28.03.2024

Kryetar i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi